



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHERBIMEVE TE KUJDESIT SHENDETESOR
Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has

Prot. Nr 328/

Krume, me 27/07 2021

Lenda Dergim informacioni

Drejtuar Qendres "Res Publica"
Blv. "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7
TIRANE

Me date 26.07.2021 ne Drejtorine e Sherbimit Spitalor Has eshte protokolluar kerkesa nr 78/21 prot date 23.07.2021 e Qendres "Res Publica" me seli ne Tirane, e cila per periudhen 2019/2020 si dhe janar-qershor 2021 kerkon informacion ne lidhje me numrin e pacienteve te shtruar ne Spitalin Bashkiak Has me Covid-19, numrin e pacienteve te infektuar me Covid-19 qe kane pasur nevojte per oksigjen medikal, numrin e operacioneve te kryera, nje kopje te procedurave te tenderave te zhvilluara nga Spitali Bashkiak Has per furnizimin me oksigjen medical si dhe nje kopje te kontratave te lidhura nga Spitali Bashkiak Has per furnizimin me oksigjen medical.

Bazuar ne piken 3 te ligjit nr 119/2014 date 18.09.2014 "Per te drejten e informimit", ju informojme se Spitali Bashkiak Has nuk ka qene pjese e skenareve per trajtimin e pacienteve te prekur nga COVID-19, nisur nga kjo ne spitalin tone eshte kryer vetem triazhimi i rasteve COVID-19 e cila per periudhen qe ju kerkoni per vitin 2020 kane qene 220 paciente, per vitin 2019 nuk kemi pasur raste si dhe per periudhen janar-qershor 2021 kane qene 162 paciente, pra ne total 382 paciente. Spitali Bashkiak Has nuk ka sherbim kirurgjie dhe pacientet qe kane nevojte per kete sherbim i referojme ne Spitalin Rajonal Kukes ose ne Spitalet Universitare ne Tirane, pra ne spitalin tone nuk kryen operacione.

Per furnizimin e oksigjenit medikal spitali yne ka lidhur kontrata te cilat i gjeni bashkangjitur kesaj shkrese.

Duke ju falenderuar per mirekuptimin Tuaj,

DREJTORI
Shaban PEKA

